

NJOFTIM PËR SHTYP

Zgjedhjet e sotme Presidenciale në Moldavi dhe ato Parlamentare të 26 tetorit në Gjeorgji monitorohen prej vëzhguesve të KRIIK dhe SHKD, si pjesë e Misioneve Ndërkombëtare të Vëzhgimit të ENEMOs

Sot, më 20 tetor 2024, qytetarët e Republikës së Moldavisë po u drejtohen qendrave të votimit për të zgjedhur Presidentin e vendit për katër vitet e ardhshme, si dhe për të votuar për ndryshimin e Kushtetutës me qëllim forcimin e angazhimeve pro-evropiane të vendit dhe objektivin strategjik për t'u bërë vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Pas zgjedhjeve presidenciale 2020 dhe parlamentare 2021, Presidenca, Ekzekutivi dhe Legjislativi në Moldavi janë duke punuar në një axhendë të përbashkët evropiane pro reformave dhe kundër korrupsionit dhe kanë shënuar disa arritje në këtë drejtim.

Ndërkohë edhe në Gjeorgji, të shtunën e ardhshme, datë 26 tetor 2024, do të zhvillohen Zgjedhjet Parlamentare.

Gjeorgjia ka shënuar hapa prapa në dy vitet e fundit, veçanërisht në maj të këtij viti me kalimin e një ligji i cili detyron organizatat e shoqërisë civile apo mediat, që kanë mbi 20% të të ardhurave nga financime që vijnë nga jashtë, për t'u regjistruar si organizata që i shërbejnë interesave të një vendi të huaj.

Duke njohur përparimin e Moldavisë dhe Gjeorgjisë në përmbushjen e pjeseshme të reformave të nevojshme, në dhjetor 2023, Këshilli Europian vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Moldavinë dhe t'i japë Gjeorgjisë statusin e vendit kandidat, por ky proces u ndalua në lidhje me Gjeorgjinë pas kalimit të ligjit kontrovers.

Zgjedhjet e sotme në Moldavi dhe ato të 26 tetorit në Gjeorgji po mbahen në sfondin e luftës që vijon prej më shumë se dy vjetësh në Ukrainë, pas sulmit të Federatës Ruse mbi këtë vend në shkurt të vitit 2022.

Përpos **rëndësinë jetike që kanë vetë zgjedhjet** për sigurimin e një të ardhmeje demokratike të vendit, të ndërtimit të një shteti ligjor demokratik dhe të së drejtës në interesin e gjerë të qytetarëve respektivë të këtyre dy vendeve, këto zgjedhje **shihen edhe si thelbësore për orientimin gjeopolitik të ardhshëm të tyre.**

Përpjekjet për të ndërhyrë në procesin zgjedhor në Moldavi nëpërmjet blerjes masive të votave që po kryhen publikisht nga individë të mbështetur nga Federata Ruse, përbëjnë një sfidë të rëndësishme jo vetëm për zgjedhjet aktuale, por edhe për të ardhmen e institucioneve demokratike në vend, ligjzbatimit prej tyre, si dhe të vetë thelbit mbi të drejtat e liritë e individit e të nocionit mbi vetë sistemin demokratik.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Moldavisë ka akredituar mbi 2 mijë vëzhgues vendas e ndërkombëtarë që po vëzhgojnë zgjedhjet e sotme në Moldavi.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania



Një nga organizatat ndërkombëtare që është duke vëzhguar zgjedhjet e [20 tetorit në Moldavi](#) dhe ato të [26 tetorit në Gjeorgji](#) është edhe Rrjeti European i Organizatave Vëzhguese të Zgjedhjeve (**ENEMO**), i cili ka angazhuar 136 vëzhgues ndërkombëtarë, ku Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (**KRIIK**) dhe Shoqata për Kulturë Demokratike (**SHKD**), si anëtarë të saj, kontribuojnë me një trupë prej 23 vëzhguesish shqiptarë me përvojë të spikatur në vëzhgimin vendas, apo edhe në misione të mëparshme ndërkombëtare.

KRIIK kontribuon në këto misione vëzhgimi me dy anëtarë të ekipit drejtues, **përfshirë Drejtuesin e Misionit, z. Dritan Taulla**, si dhe një vëzhgues afatgjatë e tre vëzhgues afatshkurtër në Moldavi, si dhe me gjashtë vëzhgues afatshkurtër në Gjeorgji.

Për herë të parë, një pjesë e qytetarëve të Moldavisë që jetojnë jashtë vendit¹ kanë mundësinë të votojnë me postë në këto zgjedhje. Misioni i Vëzhgimit të ENEMO-s po i kushton një vëmendje të veçantë mënyrës se si ky proces po kryhet.

Kjo është veçanërisht **me interes për vëzhguesit e angazhuar nga KRIIK e SHKD**, të cilët po e ndjekin atë **nën perspektivën e monitorimit, mbështetjes dhe mirë-realizimit të procesit të votimit me postë që për herë të parë do të aplikohet edhe në Shqipëri** në Zgjedhjet Parlamentare të majit 2025.

Përvoja e dalë nga monitorimi dhe analizat mbi sfidat me të cilat po përballët procesi zgjedhor në shoqëritë e këtyre dy vendeve, së bashku me fenomene të tjera si **abuzimi me burimet shtetërore dhe intimidimi, korrupsioni galopant e ai zgjedhor, financimi i pakontrolluar i partive politike, keq-informimi dhe dis-informimi i qëllimshëm**, etj, të cilat duket se tashmë janë në prag apo pjesë edhe e realiteteve të vendeve të tjera post-komuniste që aspirojnë vlerat euro-atlantike, e ku duket **se po gjejnë vend e po hedhin shtat sisteme të mirëfillta autokratike**, do të përdoret në vijim edhe për të rritur kapacitetet dhe ekspertizën e aktivistëve dhe organizatave tona, përfshirë ato partnere, në përpjekjet e tyre për të monitoruar, analizuar dhe luftuar për minimizimin e këtyre fenomeneve negative e regresive në realitetin e shoqërisë shqiptare.

Tiranë, më 20 Tetor 2024!

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

¹ Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Islandë, Suedi, Finlandë dhe Norvegji.